



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:199054

Datë: 11.12.2025

Numri i dokumentit: 08196866

KPPP.nr.1061/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Redoni Hm” SH.P.K., me NUI: 811287144, me seli në Obiliq, Parku i Biznesit, p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Shala, avokat në Prishtinë, kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.661/25 të datës 18.09.2025, të Përmbartuesit Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 11.12.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.661/25 të datës 18.09.2025, të Përmbartuesit Privat Driton Govori.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.661/25 i datës 18.09.2025, i Përmbartuesit Privat Driton Govori.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumë prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Redoni Hm” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.661/25 i datës 18.09.2025, me të cilin e ka lejuar

përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me numër 080525003-1 të datës 05.08.2025, me të cilin ka detyruar debitorin që të ia paguaj kreditorit borxhin e mbetur në shumën prej 28,617.09 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 04.09.2025 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, sekuestrimit të letrave me vlerë, sekuestrimit, vlerësimit, shënimit të përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, dërgimit dhe të besuarit për ruajtje, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e obligimit nga shuma e fituar, përmbarimit të pjesës së pasurisë së debitorit në shoqëritë tregtare, dorëzimit të sendeve të luajtshme dhe fitimit të së drejtës së pengut në sende të luajtshme.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se debitori me kreditorin kanë pasur të lidhur kontratë për furnizim me barna nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK, dhe nga kjo kontratë janë përmbushur të gjitha kushtet e saj dhe debitori nuk ka asnjë borxh apo detyrim ndaj kreditorit. Tutje ka shtuar se, fatura e cila është objekt përmbarimi është përmbushur nga debitori në shumën prej 257,553.86 €, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e papaguar përfshin ndëshkimet e kreditorit për shkak të vonesave të furnizimit. Ka shtuar se, sa i përket propozimit për përmbarim, urdhërblerja (porosia) për furnizim është lëshuar me datë 22.04.2025 ndërsa afati për dorëzim sipas kontratës ka qenë 30 ditë, dhe kreditori ka dështuar që ta sjell brenda afatit. Andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi është faturë e vlefshme për pagesën e detyrimit, dhe është e pranuar nga debitori siç vërtetohet nga vula e protokollimit. Sa i përket vonesave në dorëzim të mallit, ka shtuar se, me pranimin e faturës debitori ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura dhe nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim lidhur me të. Në fund ka theksuar se çdo kundërshtim i debitorit përbën çështje që kanë të bëjnë me procedurë kontestimore, dhe se vendimi për ndëshkim në vonesa është marrë në mënyrë të njëanshme nga debitori pa asnjë lajmërim paraprak për kreditorin. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe të obligoj debitorin që të paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 416.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave

që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkak të si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturës me numër 080525003-1 të datës 05.08.2025, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbartje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën e protokollimit nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se Fatura me numër 080525003-1, në vlerën prej 286,170.95 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datë 11.02.2025, dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e pranimi të datës 06.08.2025 dhe numri i

protokollit Nr.1738. Si dhe e njëjta është paguar pjesërisht në shumën prej 257,553.86 €, sipas transaksionit bankar të datës 03.09.2025, ndërsa pjesa tjetër përbën shumën e mbetur të pa përmbushur nga ana e debitorit lidhur me faturën e pranuar – objekt përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1061/25, datë 11.12.2025

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.